



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovski Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Prishtinë, 19 janar 2012

Të nderuar,

Të gjithë ish-pjesëtarët e TMK-së, kanë kaluar nëpër një proces të natyrshëm për vazhdimin e kontratave, duke iu nënshtruar:

- Ekzaminimit mjekësor;
- Fitnesit fizikë dhe
- Vlerësimeve Personale.

Procesi ishte i hapur dhe transparent, kurse Bordi është bazuar në kriteret e përmendura më lart të cilat janë vlerësuar për të gjithë ish-pjesëtarët e TMK-së që shërbejnë në FSK.

Qëllimi i kësaj letre është që individualisht ti ofrojë çdo pjesëtarë që shërben në FSK, të gjitha informatat që janë të njohura deri më tani.

1382 ish-pjesëtarët e TMK - së, që shërbejnë në FSK, i janë nënshtruar procesit të zakonshëm (ekzaminimit mjekësor, fitnesit fizik dhe vlerësimeve).

Bordi i ka dërguar rezultatet në Ministrinë e FSK-së. Ato tregojnë se **deri në njëqind pjesëtarë** kanë dështuar në këtë proces, në një ose tjetër mënyrë dhe kontratat e tyre nuk do vazhdojnë.

Ky numër përfshin edhe pjesëtarët që vullnetarisht kanë treguar se ata duan të lirohen nga shërbimi.

Ligji i Pensionit ende nuk është miratuar, por ne jemi bazuar në informacionin e dhënë nga **Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK - së, se ligji pritët** të miratohet brenda muajit shkurt/mars 2012.

Të gjithë pjesëtarët që dështuan në proces, ata që vullnetarisht kanë kërkuar lirim nga shërbimi, ose për shkak të moshës nuk mund të jenë më pjesë e FSK-së, do t'u vazhdohet shërbimi i tyre deri në miratimin e Ligjit për Pensionimin e Pjesëtarëve të FSK-së, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ata do të largohen nga FSK-ja me **Dinjitet dhe Respekt.**

Në këtë kohë ne nuk mund të ju informojmë për rezultatet e Bordit, por së shpejti do ti informojmë të gjithë pjesëtarët individualisht për rezultatet dhe të ardhmen e tyre.

Ata pjesëtarë që kalojnë këtë proces, do të ju ofrohet një kontratë e re e bazuar në vitet e shërbimit në TMK dhe FSK. Megjithatë, është e rëndësishme të thuhet se ky është një proces i natyrshëm në karrierën e një ushtaraku dhe ky do të jetë një proces i cili do të na përcjell edhe në të ardhmen dhe kontratat do të rishikohen për të parë se a është çdo pjesëtar i FSK-së, duke mbajtur performancën personale shëndetësore dhe atë fizike.

Unë do të doja të përfitoj nga ky rast të falënderoj të gjithë pjesëtarët e FSK-së për kontributin e tyre në ndërtimin e FSK-së, me atë që kemi sot dhe për të vazhduar mbështetjen e institucionit në rrugën tonë drejt integritimeve euroatlantike.

Me respekt,

Agim Çeku

Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës